



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER RIDVANA G. RUÇI  
ADRESA KAJO KARAFILI  
TEL: 683030361

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4171

Nr. koleksioni: 1944

Tirane më 16/07/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

\*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2022053240204641018



A202205324020461018

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më datë 16/07/2022, para meje Noteres RIDVANA G. RUÇI, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën KAJO KARAFILI, u paraqit personalisht:

- z. **ЕНЕА Ёngjellush QËNDRO**, i datëlindjes 05.09.1995, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, mbajtës i mjetit të identifikimit ID me Nr. J50905092H, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson **15%** (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit në shoqërinë AZ Trading shpk, me NUIS: L81515016F, nga këtu e më poshtë referuar si **“Shitësi”**,

- z. **ARMAND Bashkim QËNDRO**, i datëlindjes 31.01.1986, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, mbajtës i mjetit të identifikimit ID me Nr. I60131090F, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson **15%** (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit në shoqërinë AZ Trading shpk, me NUIS: L81515016F, nga këtu e më poshtë referuar si **“Shitësi”**,

dhe

- z. **ENO Pashko VESHI**, i datëlindjes 17.05.1982, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i mjetit të identifikimit ID me Nr. I20517072O, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, zotëruesi 1 (një) kuote që përfaqëson **70%** (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit në shoqërinë AZ Trading shpk, me NUIS: L81515016F, nga këtu e më poshtë referuar si **“Blerësi”**.

### Neni 1

#### Objekti i kontratës

1.1 Objekti i kontratës është:

Shitja nga z. Enea Qëndro, e 1 (një) kuote e cila përfaqëson **15%** (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë AZ Trading shpk, me NUIS: L81515016F tek z. Eno Veshi.

Shitja nga z. Armand Qëndro, e 1 (një) kuote e cila përfaqëson **15%** (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë AZ Trading shpk, me NUIS: L81515016F tek z. Eno Veshi.

1.2 Në këtë mënyrë z. Eno Veshi bëhet zotërues i nje kuote që përfaqëson **100%** (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë AZ Trading shpk.

### Neni 2

#### Çmimi i shitjes

2.1 Çmimi total i shitjes së kuotave i cili do t'i paguhet shitësve nga blerësi është **30** (tridhjetë) **lekë**, nga të cilat **15** (pesëmbëdhjetë) **lekë** do t'i paguhet z. Enea Qëndro dhe **15** (pesëmbëdhjetë) **lekë** do t'i paguhet z. Armand Qëndro.

2.2 Çmimi i shitjes paguhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

### Neni 3

#### Detyrimet e Palëve

3.1 Kuotat e Shitura nga pala shitëse pjesë e kuotave të Shoqërisë Az Trading shpk dhe çdo e drejtë dhe detyrim i cili buron prej këtyre kuotave, i kalojnë/transferohen në pronësi palës blerëse menjëherë me

Fq. 1



A2022053240204641018

nënshkrimin e kësaj Kontrate nga palët. Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët, shitësit, humbasin pronësinë dhe nuk do të jenë më zotërues/pronar të kuotave të shitura tek pala blerëse dhe nuk kanë dhe s'do të kenë asnjë pretendim lidhur me këtë. Gjithashtu nga ana e palës shitëse nuk ka dhe nuk do të ketë pretendime referuar dividendëve të pashpërndarë.

**3.2** Pala blerëse fiton pronësinë e kuotave me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur përpara momentit të shitjes të këtyre kuotave dhe do të lindin në vazhdim si pasojë e zotërimit të këtyre kuotave, përfshirë detyrimet ndaj institucioneve shtetërore (tatim mbi vlerën e shtuar, tatim mbi të ardhurat, tatim në burim, taksat dhe tarifatat vendore, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, gjobot dhe kamatëvonesat, faturime nga OSHEE dhe UKT etj), ndaj të tretëve, shoqërive tregtare dhe personave fizik (çdo e drejte/detyrim i cili rrjedh nga kontrata qiraje, shërbimi, enfiteoze, leasing, kredi, huaje etj) apo çdo e drejte/detyrim ndaj shoqërive tregtare dhe/ose organizate jo-qeveritare, përfshirë çdo të drejte/detyrim i/e cila nuk është përmendur shprehimisht në këtë kontratë dhe në mënyrë ligjore ose/dhe kontraktuale i takon palës blerëse.

**3.3** Palët duhet të depozitojnë kontratën pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllim që të bëhen regjistrimet përkatëse.

#### Neni 4 Të ndryshme

**4.1** Kjo kontratë hartohet në 5 kopje, në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës. Kontrata u bazua në dispozitat e ligjit Nr. 9901 Dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Kodit Civil dhe Statutit të Shoqërisë.

**4.2** Çdo mosmarrëveshje që mund të lind lidhur me këtë kontratë do të zgjidhet nga palët me mirëkuptim dhe në rast të kundërt, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

**4.3** Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

**SHITËSIT**

**ENEA QËNDRO**

*Enea Qëndro*

**ARMAND QËNDRO**

*Armand Qëndro*

**BLERËSI**

**ENO VESHI**

*Eno Veshi*

**NOTER**

**RIDVANA G. RUÇI**

**VENDIMI NR. 22, DATË 15.07.2022 I ASAMBLESË SË ORTAKËVE  
TË SHOQËRISË TREGTARE "AZ TRADING" SH.P.K**

Në Tiranë, sot më datën 15.07.2022 u zhvillua mbledhja e asamblesë së ortakëve të shoqërisë "AZ TRADING" sh.p.k në selinë e saj për shqyrtimin e rendit të ditës:

1. Shitja e kuotës së zotëruar nga ortaku z. Enea Qëndro që përfaqëson 15% të kapitalit të shoqërisë tek ortaku z. Eno Veshi.
2. Shitja e kuotës së zotëruar nga ortaku z. Armand Qëndro që përfaqëson 15% të kapitalit të shoqërisë tek ortaku z. Eno Veshi.

Ortakët e shoqërisë tregtare "AZ TRADING" sh.p.k, Tiranë,

**VËREJNË SE:**


Shoqëria "AZ TRADING" sh.p.k, Tiranë, është krijuar më datë 12.03.2018 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L81515016F më datë 15.03.2018. Ajo zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me dispozitat e Statutit të Shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi. Si rrjedhojë, në përputhje me pikat e rendit të ditës, Asambleja e Ortakëve,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë shitjen e kuotës së zotëruar nga ortaku z. Enea Qëndro që përfaqëson 15% të kapitalit të shoqërisë tek ortaku z. Eno Veshi.
2. Të miratojë shitjen e kuotës së zotëruar nga ortaku z. Armand Qëndro që përfaqëson 15% të kapitalit të shoqërisë tek ortaku z. Eno Veshi.
3. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, z. Eno Veshi bëhet ortak i vetëm i shoqërisë Az Trading shpk, duke zotëruar një kuotë që përbën 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë.
4. Depozitimim e këtij vendimi dhe kontratës së shitjes së kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë Tregtare "AZ TRADING" sh.p.k**


Enea Qëndro

  
Enea Qëndro

Eno Veshi



Armand Qëndro

  
Armand Qëndro